



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0311

OSHP: 2026/ 0322

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Batisha Ibrahim, Kimete Gashi-Brajshori dhe Vedat Poterqoi duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Grupi i Operatoreve Ekonomik GOE “Eing Com” SH.P.K. & “Mavi Deniz Cevre Hizmetleri” A.S. dhe ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE “Diga Solution” L.L.C. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “163 Ndertimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi I lumenjeve dhe kanalizimeve per mbrojtje nga vershimet - RiTender”, me numër të prokurimit: 616-25-2547-1-1-1 te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtines, me datën 06.07.2026, mori këtë:

Vendim

I. Aprovohen, si pjesërishte të bazuara ankesat e Grupit te Operatoreve Ekonomik “Eing Com” SH.P.K. & “Mavi Deniz Cevre Hizmetleri” A.S. e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 13.05.2026 me numër protokolli 0311/26, pasi procedura është trajtuar më parë me vendime paraprake të OSHP-së nr 2025/0535, 2025/0560 të datës 19.08.2025, si dhe vendimin nr. 2026/0027 të datës 26.02.2026 , konsiderohet si çështje e gjykuar (Res Judicate), ndërsa ankesa me nr 2026/0322 nuk dëshmon interes juridik material për shqyrtim ne lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: “163 Ndertimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi I lumenjeve dhe kanalizimeve per mbrojtje nga vershimet - RiTender” me nr. të prokurimit: 616-25-2547-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtines.

II. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

III. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës se operatoreve ekonomik si dhe obligohen operatorët ekonomik ankues “Eing Com” SH.P.K. & “Mavi Deniz Cevre Hizmetleri” A.S. si dhe “Diga Solution” L.L.C. që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesën për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.03.2026, Komuna e Prishtines në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “163 Ndertimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi I lumenjeve dhe kanalizimeve per mbrojtje nga vershimet - RiTender” me numër të prokurimit: 616-25-2547-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës Furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 2,000,000.00 €.

AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka anuluar kete aktivitet te prokurimit, per arsye se asnjë nga ofertat e pranura nuk eshte e përgjegjshme.

Me 04.05.2026, OE “Eing Com” SH.P.K. & “Mavi Deniz Cevre Hizmetleri” A.S. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me date 03.05.2026 po ashtu edhe OE “Diga Solution” L.L.C. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 05.05.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar një vendim përmes të cilit hedhen poshtë si te pa bazuara ankesat e te dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 13/05/2026, OE “Eing Com” SH.P.K. & “Mavi Deniz Cevre Hizmetleri” A.S. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0311/26. Ndërsa me datë 14/05/2026 OE “Diga Solution” L.L.C. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0322/26.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, OSHP ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0311/26 dhe ankesa nr. 0322/26 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Eing Com” SH.P.K. & “Mavi Deniz Cevre Hizmetleri” A.S. janë parashtruar si në vijim:

Me datë: 28.04.2026 nga KK Prishtinë jemi njoftuar përmes Letrës Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, me një vendim tendencioz, krejtësisht të pabazuar dhe të paargumentuar.

Ne si GOE nuk pajtohemi me këtë vlerësim dhe vendim të AK-së, sepse konsiderojmë se AK na ka eliminuar pa të drejtë, duke qenë se jemi të vetmit GOE të përgjegjshëm në këtë procedurë të prokurimit.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së, me datë: 04.05.2026 kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së, ndërsa me datë: 06.05.2026 AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim pa dhënë asnjë argument apo bazë mbi të cilën është nxjerrë ky vendim. Për më tepër, arsyetimi i përdorur nuk lidhet fare me pikat të cilat ne i kemi paraqitur dhe sqaruar në kërkesën për rishqyrtim.

Me këtë vendim shihet qartë se AK ka bërë shkelje të legjislacionit për Prokurim Publik, konkretisht ka bërë shkelje të parimeve bazë të LPP-së, për më shumë duke mos respektuar dy vendimet e OSHP-së, vendimin nr. 535/2025 të datës: 19.08.2025 dhe vendimin nr. 027/2026 të datës: 26.02.2026, të cilat vërtetojnë se jemi GOE i vetëm i përgjegjshëm në këtë procedurë të prokurimit.

Të gjitha pretendimet e paraqitura në njoftimin mbi vendimin e AK-së kundrejt neve si GOE janë të paqëndrueshme dhe këtë e vërtetojnë vendimet e OSHP-së, prandaj të gjitha pretendimet e lartcekura ndaj neve janë të gjykuara dhe të qarta në raport me përgjegjshmërinë tonë në këtë aktivitet të prokurimit.

Prandaj, meqenëse vendimet paraprake të nxjerra nga OSHP vërtetojnë përgjegjshmërinë tonë në këtë procedurë, konsiderojmë se kjo ankesë duhet të trajtohet si RES JUDICATA, neni 105, pika 2.16 e LPP-së.

Pretendimi i ri i paraqitur nga AK në këtë fazë pas dy vendimeve të OSHP-së për ne, do të thotë shumë, sepse shihet tendenca e qartë ndaj neve, si dhe ka të bëjë me mosrespektimin e vendimeve të OSHP-së. Mosrespektimi i vendimit të parë dhe nxjerrja e vendimit të dytë nga OSHP në favor të grupit tonë, nuk i respektohen nga AK, e cila fillon nxjerrjen e pretendimeve të reja, të cilat pas dy rivlerësimeve të tenderit paraqiten si pretendime të reja. Me këtë rast AK bën shkelje ligjore, sepse i gjithë ky vlerësim bazohet në pretendimet e një pale të tretë, siç është OJQ AVONET, kur dihet shumë mirë se çfarë OJQ-je është AVONET. Kjo OJQ nuk gëzon fare kredibilitet, për më tepër i gjithë aktiviteti i saj bazohet vetëm për qëllime të përfitimeve personale.

Vlerësimi i tenderit duke u bazuar në pretendimet e OJQ-ve të caktuara tregon mungesë integriteti dhe profesionalizmi në këtë proces.

Sipas legjislacionit për prokurimin publik, vlerësimi i tenderit është në përgjegjësinë e autoritetit kontraktues dhe jo të një pale të tretë, prandaj kjo për ne, përveçse e konsiderojmë se është shkelje ligjore, ka për qëllim dëmtimin e imazhit tonë.

Pretendimi nga ana e AK-së NUK QËNDRON për faktin se dokumentit të cilit i referohet AK me pretendimin se është “dokument i falsifikuar”, ky dokument i bashkëngjitur në ofertë nuk ka...

Për këtë pretendim ankimor fillimisht ju sqarojmë se ne jemi GOE dhe kemi ofertuar me një ofertë të përbashkët, ku pjesë e këtij grupi së bashku me OE “EING COM” SH.P.K. është edhe OE “MAVI DENIZ ÇEVRE HIZMETLERI” A.S., si anëtar i konsorciumit.

Dokumenti në fjalë nuk ka kurrfarë relevance dhe asnjë lidhje të çfarëdo natyre me aktivitetin në fjalë dhe përmbushjen e kërkesave të dosjes së tenderit, dhe nuk bëhet fjalë për falsifikimin e asnjë dokumenti i cili gjendet në ofertën tonë.

Ne jemi të vetëdijshëm për pjesëmarrjen në kontratat publike, në këtë kontekst në asnjë rrethanë nuk kemi çka të fshehim nga askush, por dhënia e qasjes në ofertë nga AK dhe ndikimi nga palët e treta është në kundërshtim me LPP-në, për më tepër është shkelje e rëndë dhe tendencë për komprometimin e të gjithë procesit.

Lidhur me këtë ju sqarojmë se VËRTETIMET sipas legjislacionit për prokurimin publik në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë do të kërkojnë të dorëzohen nga tenderuesi të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim ta shpërblejë me kontratë sipas nenit 65 të LPP-së dhe se këto dokumente do të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së.

Pra, dokumenti të cilit i referohet AK e i cili është bashkëngjitur në ofertën tonë nga anëtari i konsorciumit është jorelevant dhe nuk ka asnjë ndërlidhje në raport me dokumentacionin sipas nenit 65 të LPP-së.

Fakti që ky aktivitet i prokurimit ka qenë për një kohë të gjatë në vlerësim dhe rivlerësim si rezultat i mosrespektimit të vendimeve nga ana e AK-së, dhe se afati i fundit i dorëzimit të vërtetimeve është i shkurtër, ne kemi komunikuar në vazhdimësi me anëtarin e konsorciumit dhe i kemi kërkuar dokumentet që t'i kemi të gatshme kurdo që AK na i kërkon.

Prandaj, vërtetimet të cilat pasqyrojnë gjendjen faktike dhe të cilat ndërlidhen me nenin 65 të LPP-së, ju bashkëngjisim në këtë ankesë si sqarim për ekspertin dhe panelin shqyrtues me qëllim të pasqyrit të situatës dhe largimit të çdo dileme të mundshme sa i përket dokumenteve në fjalë.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Diga Solution” L.L.C. janë parashtruar si në vijim:

Më datë 28.04.2026 kemi pranuar Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar, me të cilin jemi informuar për eliminimin tonë nga procedura. Si Grup i Operatorëve Ekonomikë (GOE) DIGA Solutions L.L.C.; ED - Construction SH.P.K.; IMK - Industria Metalike E Kosoves SH.P.K, nuk pajtohemi me këtë vlerësim të Autoritetit Kontraktues (AK), pasi konsiderojmë se eliminimi ynë është bërë në mënyrë të padrejtë, duke qenë se ne kemi qenë i vetmi GOE i përgjegjshëm në këtë procedurë të prokurimit, gjë që mbështetet edhe nga dy vendimet paraprake me të cilat AK e kishte shpallur GOE tonë fitues, si dhe është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me faktet, provat materiale dhe vendimet e vetë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në të cilat AK pretendon se është mbështetur, me theks të veçantë se OSHP në vendimet nr. 2025/0535 të datës 30.08.2025 dhe nr. 2026/0027 të datës 26.02.2026 ka urdhëruar rivlerësim të procedurës, ndërsa AK ka dështuar të zbatojë në mënyrë të plotë dhe substanciale këto vendime duke mos kryer rivlerësim real dhe të plotë të ofertës sonë, por duke u kufizuar në konstatime formale të komisionit të vlerësimit për gjoja papërgjegjshmërinë e ofertës, gjë që bie ndesh me

detyrimin ligjor dhe parimet themelore të Ligjit për Prokurim Publik, rrjedhimisht, pas këtij eliminimi të padrejtë dhe pas vendimit të AK-së të datës 28.04.2026, kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e tenderit të GOE-së së propozuar për dhënie të kontratës si dhe të operatorëve tjerë pjesëmarrës, ndërsa më datë 29.04.2026 na është mundësuar qasja në dokumente, nga të cilat, pas shqyrtimit, kemi evidentuar shkelje të dispozitave të Legjislacionit për Prokurim Publik si dhe veprime në kundërshtim me parimet themelore të LPP-së, për më tepër, AK ka nxjerrë vendimin duke u thirrur në vendimet e OSHP-së nr. 535/2025 dhe 0027/2026, nga të cilat rezulton qartë se vendimmarrja e AK-së është në kundërshtim me LPP.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues ka dështuar që t'i trajtojë në mënyrë meritore dhe t'i shqyrtojë pretendimet konkrete të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim, duke mos dhënë përgjigje të arsyetuar lidhur me secilin pretendim thelbësor të ngritur nga ankuesi. Si rezultat i mosshqyrtimit adekuat të pretendimeve dhe mungesës së një analize të mirëfilltë juridike dhe faktike, Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë një vendim të paarsyetuar dhe në kundërshtim me parimet themelore të procedurës administrative dhe të prokurimit publik.

Një veprim i tillë përbën shkelje të parimit të transparencës, trajtimit të barabartë dhe të së drejtës për mjet juridik efektiv, të garantuara me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurim Publik, si dhe me dispozitat relevante të Kushtetutës dhe Konventës Evropiane, të cilat ankuesi do t'i elaborojë në vijim të kësaj ankese.

PRETENDIMI NUMËR 1

Sqarime lidhur me pretendimin e parë; Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo Diskriminimi Neni 56.3 të LPP-së -Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave (ndalimi i eliminimit për kritere të papërcaktuara në DT) Lidhur me pretendimin e parë të Autoritetit Kontraktues, parashtrojmë kundërshtim të plotë pasi i njëjti nuk mbështetet në prova konkrete dhe bie ndesh me dokumentacionin e dorëzuar në tender.

Pretendimi se GOE DIGA Solutions L.L.C.; ED - Construction SH.P.K.; IMK - Industria Metalike E Kosoves SH.P.K nuk ka dorëzuar Marrëveshje për themelimin e grupit në përputhje me nenin 26.15 të Rregullores për Prokurimin Publik është i pabazuar, pasi bie ndesh drejtpërdrejt me përmbajtjen konkrete të dokumentit të dorëzuar nga ana jonë, i cili përmbush në mënyrë të plotë kërkesat materiale të këtij neni. Në kuptim të nenit 26.15 të Rregullors Nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin E Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik , kërkohet që marrëveshja e grupit të përmbajë: përcaktimin e të drejtave dhe përgjegjësi të anëtarëve dhe autorizimin e liderit për veprime procedurale. Këto elemente janë të përfshira qartë dhe në mënyrë eksplicite në deklaratën tonë të dorëzuar:

–Në Nenin I të deklaratës përcaktohet themelimi i grupit dhe qëllimi i përbashkët për pjesëmarrje në aktivitetin konkret të prokurimit, duke identifikuar saktë procedurën dhe numrin e prokurimit;–Në Nenin II përcaktohet bashkimi i kapaciteteve njerëzore dhe materiale, që përbën bazën e bashkëpunimit funksional të kërkuar nga neni 26.15;–Në Nenin III përcaktohet emërtimi i grupit, duke identifikuar strukturën e konsorciumit, GEO-se;–Në Nenin IV është e shprehur qartë se “kompanitë bartin në mënyrë të përbashkët dhe veç e veç të gjitha detyrimet”, që përbën përmbushje të drejtpërdrejtë të kërkesës ligjore për përgjegjësi të përbashkët dhe individuale të anëtarëve të grupit, siç kërkohet edhe nga praktika e KRPP dhe Udhëzuesi Nr. 002/2024;–Në Nenin V përcaktohet mënyra e koordinimit dhe vendimmarrjes ndërmjet anëtarëve, që lidhet drejtpërdrejt me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre;–Në Nenin VI jepet autorizimi i qartë për

liderin e grupit (Diga Solutions L.L.C.) për të kryer të gjitha veprimet procedurale në emër të grupit, që është kërkesë eksplicite e nenit 26.15;—Në Nenin VII përcaktohet vlefshmëria juridike e deklaratës dhe efektet e saj deri në përfundimin e kontratës, duke garantuar stabilitetin juridik të marrëdhënies së grupit. Përmbajtja e Deklaratës së dorëzuar tejkalon kërkesat minimale ligjore të paraqitur në Aneksin 7 të Deklaratës për Themelimin të Grupit në Dosjen Tenderit. Në rastin konkret, GOE ka dorëzuar një Deklaratë për Themelimin e Grupit që përmban më shumë elemente sesa kërkesa minimale e paraqitur në DT. Kjo rrethanë juridike është me rëndësi thelbësore, pasi tregon përmbushje substanciale dhe të zgjeruar të kërkesës ligjore, dhe jo mungesë apo devijim.

Nga kjo rezulton qartë se dokumenti i dorëzuar përmban të gjitha elementet substanciale të kërkuara me nenin 26.15, dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet si mungesë e marrëveshjes. Pretendimi i vendimit të OSHP-së dhe i ekspertit se dokumenti nuk përmban “formatin standard” nuk ka bazë ligjore si kusht eliminues, sepse një kërkesë e tillë nuk është publikuar në mënyrë të plotë në Dosjen e Tenderit. Siç rezulton nga prova materiale, Aneksi 7 i publikuar nga AK përmban vetëm një faqe të pjesshme dhe në kundërshtim me vetë nenin 26.15. Praktika e qëndrueshme e OSHP-së dhe parimi bazë i prokurimit publik (neni 56.3 i LPP-së) ndalon eliminimin e operatorëve ekonomikë për kritere që nuk janë të përcaktuara qartë dhe në mënyrë të plotë në Dosjen e Tenderit. Në këtë rast po aplikohet një standard (formular i plotë KRPP) që nuk ka qenë pjesë reale e dokumentacionit të publikuar dhe i qasshëm aty ku referohet në Dosjen e Tenderit, aplikimi i kësaj si kusht eliminues përbën shkelje të nenit 7, nenit 56.3, nenit 59 dhe nenit 72 të LPP-së, si dhe të parimeve të sigurisë juridike; dhe për rrjedhojë, ky pretendim duhet të refuzohet si i pabazuar, ndërsa çdo vendim i mbështetur mbi të është i kundërligjshëm dhe i cenueshëm në tërësi.

Në këtë kontekst, aplikimi i një standardi që nuk ka qenë i publikuar dhe i qasshëm bie ndesh me:— nenin 7 të LPP-së (barazia në trajtim dhe qasja e barabartë në informacion);— nenin 56.3 të LPP-së (ndalimi i eliminimit për kritere të papërcaktuara në DT);— nenin 1 të LPP-së dhe parimin e sigurisë juridike (parashikueshmëria e kërkesave);

Sipas nenit 7 të LPP-së (Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi), autoriteti kontraktues ka detyrim të sigurojë qasjen e barabartë në informacion për të gjithë operatorët ekonomikë. Në rastin konkret, mungesa e publikimit të plotë të formularit standard aty ku udhezohet në DT dhe mosqasja reale në të njëjtin përbën shkelje të këtij neni, sepse krijon situatë ku operatorët nuk kanë pasur mundësi objektive të përmbushin një kërkesë në formën që pretendohet më vonë gjatë vlerësimit. parashikueshmëria (siguria juridike).

Në vazhdim gjeni dëshminë:

Sipas nenit 1 të LPP-së dhe parimeve të sigurisë juridike (neni 1 dhe 2 i Ligjit për Procedurën Administrative), kërkesat duhet të jenë të qarta, të parashikueshme dhe të aksesueshme. Një kërkesë që nuk është publikuar në mënyrë të plotë dhe nuk ka qenë e qasshme nuk mund të prodhojë pasoja eliminuese për operatorët ekonomikë.

Në vazhdim gjeni dëshminë:

Gjithashtu, në përputhje me Udhëzuesin Nr. 002/2024, refuzimi pa sqarim lejohet vetëm në rast se mungon deklarata e themelimit të grupit ose mungon deklarata për përgjegjësi të përbashkët, ndërsa në rastin konkret:— Deklarata ekziston;— Është e nënshkruar nga të gjithë anëtarët;— Përmban shprehimisht përgjegjësi të përbashkët dhe individuale (neni IV); prandaj nuk

plotësohen kushtet për eliminim bazuar në dispozitat e të deklaratës së dorëzuar dhe e legjislacionit në fuqi rezulton se:– Marrëveshja e grupit është dorëzuar dhe përmbush plotësisht kërkesat ligjore;– Pretendimi për “mungesë” është në kundërshtim me faktet;– Pretendimi për “formë të paplotë” është pasojë e dështimit për të publikuar formularin standard në DT;– Çdo eliminim mbi këtë bazë është në kundërshtim me nenin 7, 56.3, 59 dhe 72 të LPP së me Udhëzuesin 002/2024;dhe me nenin 26.15 të Rregullores; dhe si i tillë, nuk qëndron juridikisht. Prandaj, nuk kemi rast të mungesës së dokumentit, por në rastin më të lartë një çështje interpretimi formal, e cila sipas vetë Udhëzuesit nuk mund të jetë bazë për eliminim, por vetëm për sqarim sipas nenit 59 dhe 72 të LPP-së.

PROVAT MATERIALE DHE DOKUMENTARE - PRETENDIMI NUMËR 1

Në mbështetje të pretendimeve tona, bashkëngjitur kësaj ankese dorëzojmë prova materiale dhe digjitale, të cilat vërtetojnë në mënyrë objektive përmbushjen e kërkesës së nenit 26.15 të Rregullores për Prokurimin Publik, konkretisht: –Kopjen e plotë të Deklaratës për Themelimin e Grupit (Aneksi 7) të dorëzuar në ofertë;

– Dokumentimin fotografik të faqes së dorëzuar në dosjen e tenderit ku evidentohet

përmbajtja e deklaratës;– Regjistrime digjitale (screenshot / video capture) të qasjes në faqen zyrtare të KRPP-së në periudhën e publikimit të aktivitetit, të cilat dëshmojnë mungesën e publikimit të formularit standard të kërkuar në Dosjen e Tenderit;– Kopjen e Dosjes së Tenderit ku evidentohet se është publikuar vetëm një faqe e pjesshme e Aneksit 7, pa strukturën e plotë standarde të KRPP-së.

Këto prova janë të gjeneruara në mënyrë teknike dhe të verifikueshme dhe përbëjnë dokumentacion të pranueshëm në procedura administrative dhe shqyrtuese, pasi dëshmojnë gjendjen faktike në momentin e shpalljes së aktivitetit.

REKOMANDIMET E DEPARTAMENTIT TË MONITORIMIT TË KRPP-SË (dokument i datës 25.02.2025)

Nga dokumenti zyrtar i Departamentit të Monitorimit të KRPP-së, datë 25.02.2025, rezulton se ky departament ka shqyrtuar Dosjen e Tenderit dhe dokumentacionin përkatës të aktivitetit të prokurimit.

Në kuadër të këtij shqyrtimi: Janë dhënë rekomandime të caktuara procedurale dhe teknike; Këto rekomandime janë zbatuar nga Autoriteti Kontraktues; Nuk është konstatuar parregullsi lidhur me përmbajtjen apo formën e Dosjes së Tenderit, përfshirë Aneksin 7 – Deklaratën për Themelimin e Grupit të Operatorëve Ekonomikë;

Nuk është evidentuar mungesë e ndonjë formulari standard të detyrueshëm në lidhje me këtë element. Këto konstatime janë relevante për vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës dhe ndërlidhen drejtpërdrejt me argumentet e paraqitura në parashtresën e datës 22.01.2026.

Fakti që gjatë këtij monitorimi nuk është konstatuar asnjë mungesë standardi apo parregullsi materiale në Dosjen e Tenderit, përbën element objektiv që kundërshton pretendimet për mungesë të Deklaratës sipas ANEKSIT 7 TË THEMELIMIT TË GRUPIT sipas dosjes së tenderit.

Kjo situatë krijon shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 7 të LPP-së (barazia në trajtim dhe qasja e barabartë në informacion), si dhe të parimit të sigurisë juridike, pasi operatorët ekonomikë nuk mund të obligohen të respektojnë një format që nuk është publikuar në mënyrë të plotë dhe të aksesueshme.

Në përputhje me praktikën e qëndrueshme të OSHP-së:– Vendimet e OSHP-së obligojnë Autoritetin Kontraktues të bëjë rivlerësim;– Por nuk e zëvendësojnë vlerësimin e ri të ofertës;– AK ka detyrim të kryejë rivlerësim të plotë dhe substancial në përputhje me LPP, rregulloret dhe udhëzimet.

Në këtë rast, çdo eliminim i bazuar në mungesë formale të një formulari që nuk ka qenë i publikuar në mënyrë të plotë përbën shkelje të parimeve të rivlerësimit të drejtë dhe të nenit 59 dhe 72 të LPP-së.

Në të drejtën e prokurimit publik dhe në praktikën e konsoliduar të OSHP-së, vlen parimi themelor:

“Substanca e dokumentit ka përparësi ndaj formës së tij.” Kjo do të thotë se një dokument nuk mund të konsiderohet i pavlefshëm vetëm për shkak të mungesës së formatit standard, nëse përmbajtja e tij realizon qëllimin juridik të kërkesës. Në këtë rast:– Qëllimi i nenit 26.15 është siguria e bashkëpunimit dhe përcaktimi i përgjegjësisë;– Ky qëllim është arritur në mënyrë të plotë përmes deklaratës së dorëzuar;– Prandaj, mungesa eventuale e formatit standard nuk mund të prodhojë efekt eliminues.

Vendimet e OSHP-së, në vend që të vlerësojnë nëse dokumenti përmbush qëllimin juridik të nenit 26.15, ka bërë një kualifikim të gabuar juridik, duke e trajtuar një dokument të dorëzuar dhe substancialisht të plotë si “mosdorëzim të marrëveshjes”. Ky interpretim është në kundërshtim me parimet bazë të LPP-së.

PRETENDIMI NUMËR 2

Sqarime lidhur me pretendimin e dytë; Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve. Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi.

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë. Neni 113 i LPP-së - Shqyrtimi fillestar nga eksperti shqyrtues. Neni 114 i LPP-së - Përgjegjësitë e ekspertit shqyrtues dhe të autoritetit kontraktues Kërkesa e Dosjes së Tenderit (pika 9.1 & 9.2) është e qartë dhe e kufizuar: “Operatorët

ekonomik duhet të dorëzojnë autorizim nga prodhuesi apo distributori i dedikuar për këtë projekt për shitje dhe mirëmbajtje...” dhe “Autorizim nga prodhuesi ose distributori – origjinal ose kopje”; në këtë formulim NUK ekziston kërkesë eksplicite ligjore apo kontraktuale që OE të dëshmojë marrëdhënien juridike ndërmjet prodhuesit dhe distributorit me dokument shtesë (p.sh. kontratë distributori, konfirmim nga prodhuesi për distributorin, etj.); rrjedhimisht çdo interpretim që shton këtë kriter përbën zgjerim të paligjshëm të kërkesave të DT-së në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së (trajtim i barabartë dhe jo-diskriminim) dhe praktikën e qëndrueshme se AK/OSHP nuk mund të aplikojnë kritere që nuk janë të publikuara në DT. GOE ka dorëzuar autorizim nga një subjekt që vepron si distributor/përfaqësues (Solomon Consultants), pra ka përmbushur tekstin literal të kërkesës “nga prodhuesi ose distributor”; kërkesa është alternative (OSE), jo kumulative; për rrjedhojë nuk mund të kërkohet njëkohësisht

edhe autorizim direkt nga prodhuesi edhe dëshmi shtesë për distributorin, sepse kjo do të ishte ndryshim i kriterit pas dorëzimit të ofertave, në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe parimin e sigurisë juridike Pretendimi se autorizimi “nuk është i dedikuar për këtë projekt” është juridikisht i pabazuar sepse DT nuk ka përcaktuar format, përmbajtje minimale, apo obligim për referencë të numrit të prokurimit në autorizim; në mungesë të një kërkesë të tillë të qartë në DT, nuk mund të penalizohet OE për mosplotësim të një elementi që nuk është kërkuar kjo bie ndesh me nenin 7 të LPP-së dhe me parimin e parashikueshmërisë (neni 1.2 i Ligjit për Procedurën Administrative) Edhe nëse supozohet se ka paqartësi mbi statusin e distributorit, kjo situatë bie drejtpërdrejt në fushën e sqarimeve sipas nenit 59.4 të LPP-së: “Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë që të sqarojnë ose plotësojnë dokumentet...” dhe nenit 72 të LPP-së për verifikim të informatave; AK realisht e ka përdorur këtë të drejtë me datë 24.12.2025 dhe GOE ka kthyer përgjigje me 27.12.2025 duke dorëzuar:

- Authorisation Environment Solutions
- Confirmation Letter
- Link verifikimi publik që dëshmon statusin e Solomon Consultants si përfaqësues për rajonin përfshirë Kosovën.

Kjo përbën saktësisht situatë të paraparë në nenin 59.4: sqarim i dokumentit ekzistues, jo ndryshim i ofertës

Refuzimi për të marrë parasysh këto sqarime nga OSHP-ja bie ndesh drejtpërdrejt me vetë arsyetimin e ekspertit në të njëjtën lëndë, ku për raste të tjera (sigurimi i tenderit) është pranuar aplikimi i nenit 59.4 dhe 72 të LPP-së dhe është konsideruar se gabimet teknike nuk e bëjnë ofertën të papranueshme; ky është standard i dyfishtë juridik:

Në një rast lejohet sqarimi për dokument me ndikim financiar (sigurimi i tenderit) Në rastin konkret refuzohet sqarimi për një dokument teknik/verifikues Kjo përbën shkelje të parimit të konsistencës dhe barazisë në vendimmarrje Është sqaruar dhe konfirmuar me dokumente shtesë dhe burime publike rrjedhimisht nuk kemi mungesë dokumenti, por maksimumi paqartësi që trajtohet me nenin 59 dhe 72 të LPP-së.

Mosmarrja në konsideratë e parashtresës së datës 22.01.2026 dhe dokumenteve shtesë (B47 sqarimet) të datës 22.01.2026 përbën shkelje procedurale të rëndë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së, pasi është detyrim të shqyrtohen të gjitha provat relevante të dorëzuara në procedurë; injorimi i provave materiale dhe digjitale që vërtetojnë statusin e distributorit e bën vendimin të mangët në arsyetim dhe të cenueshëm juridikisht

- Kërkesa e DT është përmbushur sipas formulimit “prodhues OSE distributor”
- Nuk ekziston kërkesë për dëshmi shtesë të marrëdhënies distributor–prodhues
- Çdo kërkesë e tillë është interpretim i zgjeruar dhe i paligjshëm
- Edhe në rast paqartësie, sqarimet janë dhënë dhe janë në përputhje me nenin 59.4 dhe 72

të LPP-së

- Janë aplikuar standarde të dyfishta dhe janë injoruar prova relevante

PROVAT MATERIALE DHE DOKUMENTARE - PRETENDIMI NUMËR 2

Autorizimi nga Solomon Consultants d.o.o.

- dokument i dorëzuar në ofertë që autorizon DIGA Solutions për shitje dhe mirëmbajtje të produkteve të Environment Solutions AsP në Kosovë

Dokumentet shtesë të dorëzuara në sqarim (27.12.2025)

- Authorisation Environment Solutions
- Confirmation Letter

Verifikimi publik online i statusit të distributorit

- link zyrtar: <https://www.solomonconsultants.net/where-we-operate-1>
<https://static1.squarespace.com/static/6044a5fe133ffa41758ddd2a/t/688c4823c26ef460b1fd6e7f/1754023973875/exclusive-solomon-letter-FINAL.pdf>

Kërkesa për sqarim nga AK (24.12.2025)

Përgjigja në sqarim nga GOE (27.12.2025)

Parashtresa drejtuar OSHP (22.01.2026) me prova shtesë (B47)

- përfshin të gjitha sqarimet dhe dokumentet mbështetëse
- provon se OSHP ka pasur në dispozicion prova të plota

PRETENDIMI NUMËR 3

Sqarime lidhur me pretendimin e tretë; Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve. Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi.

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë. Pretendimi Ankimor 3 i paraqitur në vendimet nr. 2025/0535 të datës 30.08.2025 dhe nr. 2026/0027 të datës 26.02.2026 së OSHP-së është i pabazuar, pasi kërkesa e Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit është për përbërjen teknike të produktit, konkretisht që tubat të jenë të ndërtuar me dy shtresa prej materialeve PP (polipropilen) dhe PE (polietilen), ndërsa GOE i rekomanduar ka dëshmuar përmbushjen e kësaj kërkesë përmes dokumentacionit të dorëzuar dhe të sqaruar në procedurë; fillimisht është dorëzuar katalogu teknik, ndërsa pas kërkesës për sqarim nga Autoriteti Kontraktues me datë 24.12.2025, GOE ka dorëzuar në afat me datë 27.12.2025 dokumentin teknik “tubes-pro-tech-sheet-10” si dhe referencë zyrtare të verifikueshme nga prodhuesi, në të cilin në mënyrë të qartë specifikohet “Outer material: Polypropylene (PP)” dhe “Inner material: Polyethylene (PE)”, duke plotësuar në tërësi kërkesën e Dosjes së Tenderit; në kuptim të nenit 59 paragrafi 4 të LPP-së dhe nenit 72 të LPP-së, kjo përbën sqarim dhe konfirmim të dokumentacionit ekzistues dhe nuk paraqet ndryshim të ofertës, pasi produkti i ofertuar mbetet i njëjtë dhe vetëm qartësohen karakteristikat e tij teknike; vetë eksperti shqyrtues konstaton se “pretendimi është pjesërisht i bazuar, pasi dokumentacioni nuk përmban specifikimin e kërkuar, por kjo situatë mund të ishte

sqaruar nga Autoriteti Kontraktues pa ndryshuar ofertën në thelb”, çka përbën pranim të drejtpërdrejtë se nuk kemi të bëjmë me mangësi që e bën ofertën të papranueshme dhe se trajtimi i drejtë juridik është sqarimi dhe jo penalizimi; për më tepër në këtë rast dokumentacioni ekziston dhe është plotësuar përmes sqarimeve të kërkuara nga vetë Autoriteti Kontraktues; mosmarrja në konsideratë e dokumenteve të dorëzuara në sqarim dhe e provave të bashkëngjitura në parashtresën e datës 22.01.2026 përbën shkelje të nenit 113 dhe 114 të LPP-së, pasi organi shqyrtues ka detyrim të shqyrtojë të gjitha provat relevante të paraqitura në procedurë; rrjedhimisht, konstatimi se GOE nuk ka ofruar dëshmi për materialet PP dhe PE është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe me dispozitat e LPP-së, ndërsa vetë pranimi i ekspertit për mundësinë e sqarimit e përjashton çdo bazë ligjore për trajtim negativ të ofertës.

PROVAT MATERIALE DHE DOKUMENTARE – PRETENDIMI NUMËR 3

— Katalogu teknik i dorëzuar në ofertë

- përmban të dhëna mbi produktin (dimensione, konfigurim, përdorim)
- dëshmon ekzistencën e dokumentacionit teknik për produktin e ofertuar
- provon se nuk kemi mungesë të dokumentit, por çështje të nivelit të detajimit të informacionit

— Kërkesa për sqarim nga AK (24.12.2025)

- dëshmi se Autoriteti Kontraktues nuk e ka trajtuar çështjen si mungesë eliminatore
- aplikim praktik i nenit 59.4 të LPP-së dhe nenit 72 të LPP-së
- konfirmon se kemi të bëjmë me situatë të sqarimit dhe jo refuzimit

— Përgjigja në sqarim nga GOE (27.12.2025)

- dokument zyrtar i dorëzuar në afat sipas kërkesës së AK
- përmban sqarim të plotë të specifikimeve teknike të produktit
- dëshmon bashkëpunimin dhe përmbushjen e detyrimeve procedurale nga OE

— Dokumenti teknik “tubes-pro-tech-sheet-10” (i dorëzuar në sqarim)

- përmban specifikim të drejtpërdrejtë dhe të qartë të materialeve:– Outer material: Polypropylene (PP)– Inner material: Polyethylene (PE)
- përmbush në tërësi kërkesën e Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit
- provon pa asnjë ekuivok përbërjen e produktit të ofertuar

— Burimi zyrtar i prodhuesit (verifikim publik online)

- link: <https://nofloods.com/catalogues/>
- dëshmi publike dhe e verifikueshme e specifikimeve teknike të produktit
- përforcon autenticitetin dhe besueshmërinë e dokumentit teknik të dorëzuar

— Parashtresa drejtuar OSHP (22.01.2026) me dokumentet B47

- përfshin dokumentin teknik dhe referencat përkatëse
- dëshmon se provat janë paraqitur dhe kanë qenë në dispozicion të organit shqyrtues
- provon se OSHP ka pasur mundësi reale për vlerësim të plotë
- dokumentacioni nuk përmban specifikimin e kërkuar, por kjo situatë mund të ishte sqaruar nga Autoriteti Kontraktues pa ndryshuar ofertën në thelb”
- dëshmi se nuk kemi mangësi thelbësore dhe se rasti hyn në fushën e sqarimeve sipas nenit 59.4 të LPP-së

PRETENDIMI NUMËR 4

Sqarime lidhur me pretendimin e katërt; Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimidhe Krahësimi i Tenderëve. Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi. Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë. Neni 113 i LPP-së – Shqyrtimifillestar nga eksperti shqyrtues. Neni 114 i LPP-së - Përgjegjësitë e ekspertitshqyrtues dhe të autoritetit kontraktues

Në Dosjen e Tenderit, Aneksi 1 – Specifikimet Teknike, është përcaktuar qartë se Vinçi “lidhjet hidraulike duhet të jenë në përputhje me ISO-16028 ose ISO-7241 Lloji A”, çkapërbën kërkesë për përputhshmëri teknike të produktit dhe jo kërkesë për dorëzim të certifikatave ISO si dokument i veçantë kualifikues apo eliminues, andaj interpretimi semungesa e një certifikate të posaçme përbën mosplotësim të kërkesës tejkalon përmbajtjen DT dhe bie ndesh me parimin e ligjshmërisë të përcaktuar në nenin 7 të LPP-së, sipas të cilit autoriteti kontraktues dhe organet shqyrtuese janë të detyruara të vlerësojnë ofertatvetëm në bazë të kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe jo të shtojnë kritere tëreja ex post; nga dokumentacioni i ofertës së GOE të rekomanduar, përfshirë specifikimet teknike të vinçit hidraulik dhe broshurën zyrtare të prodhuesit NoFloods Hydraulic Winchtë verifikueshme në <https://nofloods.com/catalogues/>, rezulton se pajisja është e pajisurme lidhje hidraulike të standardizuara sipas ISO 16028 ose ISO 7241 Lloji A, si pjesë e konfigurimit të saj teknik dhe fabrikues, duke dëshmuar përputhshmëri substanciale me kërkesën e DT, ndërsa gjatë procedurës së vlerësimit AK ka zbatuar nenin 59 paragrafi 4të LPP-së duke kërkuar sqarime me datë 24.12.2025, dhe GOE ka dorëzuar përgjigje me datë 27.12.2025 duke bashkëngjitur dokumentacion shtesë dhe burim zyrtar verifikimi (B47), përmes të cilit është konfirmuar në mënyrë të qartë përputhshmëria teknike epajisjes me standardet e kërkuara, pa ndryshuar përmbajtjen e ofertës por vetëm duke esqaruar dhe verifikuar atë, çka është në përputhje të plotë me nenin 59.4 të LPP-së; gjithashtu sipas nenit 72 të LPP-së autoriteti kontraktues ka obligim ligjor të vlerësojë ofertën në mënyrë të plotë dhe të drejtë duke marrë parasysh të gjitha dokumentet, sqarimet dhe provat e dorëzuara gjatë procedurës, ndërsa mosmarrja parasysh e dokumentacionit të dorëzuar në sqarim dhe broshurës zyrtare të prodhuesit përbën shkeljetë këtij obligimi dhe cenim të parimit të trajtimit të barabartë dhe transparencës; po ashtu, sqarimet janë të lejueshme dhe të detyrueshme për t’u marrë në konsideratë kur bëhet fjalë për paqartësi teknike dhe jo për ndryshim të ofertës ose mungesë të dokumentit thelbësor, ndërsa në rastin konkret kemi të bëjmë me konfirmim të përputhshmërisë teknike dhe jome plotësim të një mungese materiale; rrjedhimisht, konstatimi i OSHP-së dhe ekspertitshqyrtues se mungesa e referencës së drejtpërdrejtë në certifikatë përbën papërgjegjshmëri është i gabuar juridikisht, pasi nuk ekziston kërkesë eksplicite për certifikim

ISO në DT dhe përputhshmëria është dëshmuar përmes dokumentacionit teknik dhe sqarimeve të pranuar në procedurë, andaj vendimi 0027/26 i OSHP-së është i pabazuar në ligj dhe në prova materiale, duke cenuar nenet 7, 59.4 dhe 72 të LPP-së dhe parimet themelore të prokurimit publik.

PROVAT MATERIALE DHE DOKUMENTARE – – PRETENDIMI NUMËR 4

- Aneksi 1 – Specifikimet teknike (kërkesë për ISO-16028 ose ISO-7241 pa certifikatë të detyrueshme)
- Dokumentacioni teknik i vinçit hidraulik i dorëzuar në ofertë
- Letra e AK për sqarim e datës 24.12.2025 (neni 59.4 LPP)
- Përgjigjja e GOE e datës 27.12.2025 (B47)
- Broshura zyrtare e prodhuesit NoFloods (<https://nofloods.com/catalogues/>) e verifikueshme publikisht
- Parashtresa drejtuar OSHP me sqarimet dhe dokumentet mbështetëse
- Vendimi i OSHP 0027/26
- Neni 7, neni 59.4 dhe neni 72 i LPP-së
- Udhëzuesi 002/2024 për sqarime teknike pa ndryshim të ofertës Sa i përket rivlerësimit të ofertave nga Autoriteti Kontraktues, pas qasjes në dokumentet e tenderit, kemi identifikuar se G.O.E. “EING COM” SH.P.K. & “MAVI DENIZ ÇEVRE HIZMETLERI” A.S. ka paraqitur dokumentacion i cili përmban mospërputhje të theksuara, të natyrës materiale dhe juridike, të cilat e bëjnë këtë ofertë të dyshimtë, të paqëndrueshme dhe të papërputhshme me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me parimet themelore të ligjshmërisë, transparencës dhe integritetit në prokurimin publik.

Në veçanti, për përmbushjen e kriterit: Kapaciteti teknik dhe profesional 9.1 & 9.2, Nr. 5 të Dosjes së Tenderit, i cili kërkon paraqitjen e një raporti të vlefshëm vlerësimi për sistemin mobil të mbrojtjes nga vërshimet dhe përmbytjet, të lëshuar nga një institucion i pavarur dhe relevant, është analizuar dokumenti i titulluar “Inspection Report Nr: 314 R”, me referencë IDD.1035.10.A41 dhe datë 15.02.2011, i atribuar subjektit Bureau Veritas dhe i lidhur me operatorin ekonomik Mavi Deniz Çevre Hizmetleri A.S.

Konkretisht, është konstatuar se fotografitë e përfshira në raport nuk reflektojnë një proces real inspektimi të produktit të deklaruar, por rezultojnë të jenë të marra dhe të ripërdorura nga burime të hapura online dhe materiale të publikuara nga subjekte të tjera

tregtare, përfshirë Beaver Schutzsysteme AG, Neodis Equipements, Topin Inflatable dhe LT Canopy.

Është identifikuar përputhje vizuale dhe përmbajtësore me materiale të lidhur drejtpërdrejt me operatorin ekonomik Beaver Schutzsysteme AG, i cili është gjithashtu pjesëmarrës në të njëjtën procedurë të prokurimit, çka krijon dyshim të bazuar për përdorim të materialeve të palëve të treta për të mbështetur dokumentacionin e dorëzuar. Këto përputhje janë verifikuar përmes krahasimit të drejtpërdrejt të materialeve të raportit me burimet përkatëse publike online, duke

rezultuar në mungesë të lidhjesfaktike ndërmjet dokumentit dhe një procesi real inspektimi.

Duke pasur parasysh natyrën dhe përmbajtjen e këtij dokumenti, ekzistojnë dyshime të forta dhe të bazuara se edhe dokumente të tjera të dorëzuara në kuadër të kësaj oferte janë të modifikuara, jo autentike dhe të pavërteta. Këto mospërputhje nuk paraqiten si rastetë izoluar, por dëshmojnë për një model të përsëritur dhe sistematik të paraqitjes së dokumentacionit të dyshimtë, me qëllim të përmbushjes formale të kriterëve të dosjes së tenderit dhe përfitimin ekonomik me dokumente të pavërteta dhe të modifikuara.

Në këtë kontekst, përmes analizës së detajuar të dokumentit “Inspection Report Nr: 314R”, është konstatuar se përmbajtja vizuale e tij nuk pasqyron një inspektim real, të dokumentuar dhe të verifikueshëm të produktit të deklaruar, por përfshin materiale të

identifikuara në burime të hapura online, konkretisht produkte të kompanive:

2. Provë materiale. Në vazhdim gjeni dëshminë: Në dokumenti e dorëzuar: BVCertificate - Flood Boom Inspection Report e paraqitur në faqen 5, foto (Flood Boom) General View

Provë materiale: I njëjti produkt prodhim i kompanisë: NEODIS EQUIPEMENTS

FOTO:

Verifikimi: <https://www.neodisequipements.com/produit/boudin-barrage-de-retention-anti-inondation/>

2. Në dokumenti e dorëzuar: Inspection Report e paraqitur në faqen 6, foto Flood II General View

Provë materiale: I njëjti produkt prodhim i kompanisë: BEAVER

SCHUTZSYSTEME AG, FOTO: Në Inspection Report i paraqitur si Flood II General View

Verifikimi: <https://www.facebook.com/beaver.schutz>

3. Provë materiale: I njëjti produkt Chinatopinflatables.com FOTO: Në Inspection Report i paraqitur si Flood III General View

Verifikimi: <https://www.ltcanopy.com/Inflatable-Quick-Dam-Flood-Barrier-pd42408461.html>

PROVAT MATERIALE DHE DOKUMENTARE

1. Parashtresë dërguar AK— Dyshime mbi autenticitetin e dokumentit dhe kërkesës për verifikim të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik konkures: ‘Inspection

Report Nr:314 R’, data 16.04.2026

2. Kopjet e dokumenteve te verifikuara, fotografive të paraqitur në parashtresën ederguar dhe azhuruar si provë ne platformen zyrtare E-prokurimi. Gjithashtu është evidentuar edhe përdorimi i certifikatave ISO me të njëjtin QRcode si dhe mungesa e QR code në certifikaten tjetër të dorëzuar, çka bie ndesh me praktikat standarde ndërkombëtare të certifikimit dhe verifikimit elektronik të dokumenteve. Këto elemente, të marra së bashku, krijojnë një model të përsëritur të parregullsive dokumentare që cenon besueshmërinë dhe ligjeshmërinë e të gjithë ofertës.

PROVAT MATERIALE DHE DOKUMENTARE

3. Parashtresë dërguar AK– Dyshime serioze mbi autenticitetin e dokumentit të paraqitur në certifikatat ISO, data 06.05.2026.

4. Kopjet e Certifikave ISO te verifikuara të paraqitur në parashtresën e dërguar dhe azhuruar si provë ne platformen zyrtare E-prokurimi.

Pretendimi nr. 1 i ankuesit G.O.E. “EING COM” SH.P.K. & “MAVI DENIZÇEVRE HIZMETLERI” A.S, i cili është pranuar edhe nga Paneli Shqyrtues ne vendimet e OShP-së nr. 535/2025 dhe 0027/2026 lidhur me vlefshmërinë e Certifikatës CE dhe deklarimit të konformitetit nga vetë prodhuesi, është vlerësuar pa u administruar dhe pa u shqyrtuar në tërësi gjendja faktike dhe autenticiteti i dokumentacionit mbi të cilin mbështetet vetë deklarimi i konformitetit. Vetë fakti që dokumentacioni teknik dhe vizual i paraqitur nga prodhuesi përmban produkte, fotografi dhe materiale të operatorëve të tjerë ekonomikë, përfshirë edhe subjekte konkurruese pjesëmarrëse në të njëjtën procedurë të prokurimit, e rrëzon kredibilitetin, besueshmërinë dhe autenticitetin e të gjithë dokumentacionit mbështetës, përfshirë deklarimet mbi CE konformitetin dhe raportet e inspektimit. Në këto rrethana, Paneli Shqyrtues dhe Autoriteti Kontraktues nuk kanë mundur të arrijnë në përfundim të drejtë dhe të ligjshëm lidhur me vlefshmërinë e CE deklarimit, pa verifikuar paraprakisht autenticitetin e dokumenteve bazë dhe të dhënave teknike të paraqitura nga prodhuesi. Bazuar në këto të gjetura, rezulton se edhe pretendimet tjera të ankuesit janë të pabazuara, pasi janë mbështetur në dokumentacion jo autentik, të modifikuar dhe në materiale që u përkasin operatorëve të tjerë ekonomikë, duke e bërë të pabesueshëm dhe juridikisht të paqëndrueshëm të gjithë vlerësimin e ofertës. Çdo vendim marrje e organeve kompetente e bazuar në dokumentacion të tillë të dyshimtë do të përbënte shkelje të rëndë të parimeve themelore të Ligjit për Prokurimin Publik dhëdo të komprometonte ligjshmërinë e gjithë procedurës. Për këtë arsye, kërkojmë nga OShP-ja që të urdhërojë verifikim të plotë, të pavarur dhe institucional të të gjitha dokumenteve të kontestuara, si dhe të mos pranojë si të mirëqena prova që mbartine elemente të qarta të manipulimit dhe përdorimit jo të rregullt juridik.

Njëkohësisht, kërkojmë që gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, OShP-ja të rivendosë ligjshmërinë, barazinë dhe objektivitetin në procedurën e prokurimit publik, duke korrigjuar padrejtësinë e shkaktuar ndaj palës sonë përmes mbështetjes së vendim marrjes në dokumentacion me autenticitet të kontestuar. Çdo tolerim i parregullsive të tilla do të cenonte rëndë besimin në sistemin e prokurimit publik dhëdo të krijonte precedent të rrezikshëm juridik në favor të operatorëve ekonomikë që paraqesin dokumentacion të pavërtetë ose të manipuluar.

PËRMBLEDHJE:

Për të gjitha arsyet e lart cekura, rezulton qartë se eliminimi i ofertes sonë është bërë në

kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, dhe me parimet themelore të sigurisë juridike, transparencës dhe trajtimit të barabartë, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve ,përfundimi i aktivitetit të prokurimit ,aftësia teknike dhe/ose profesionale, dokumentacionidhe informacioni shtesë,shqyrtimi fillestar nga eksperti shqyrtues,përgjegjësitë e ekspertitshqyrtues dhe të autoritetit kontraktues. AK nuk ka provuar asnjë rrethanë ligjore që do ta justifikonte ndërprerjen e proceduraspas hapjes së ofertave, përkundrazi që kriteret e papërcaktuara në DT sipas ligjit dhepraktikës së konsoliduar të OSHP-së e të Gjykatës Komerciale, nuk mund dhe nukguxojnë t'u barten operatorëve ekonomikë.Këtë aktivitet të prokurimit Komisioni i Vlerësimit të AK-së e ka vlerësuar dy herë,dhe në ASNJËRIN rast nuk ka arritur të evidentoj se jemi te përgjegjshëm,perkundrazi ne kemi qenë dhe jemi i vetmi GOE DIGA Solutions L.L.C.; ED -Construction SH.P.K.; IMK - Industria Metalike E Kosoves SH.P.K., Ipërgjegjshëm në këtë procedurë të prokurimit, gjë që mbështetet edhe nga dyvendimet paraprake me të cilat AK e kishte shpallur GOE tonë fitues.Prandaj, duke pasur parasysh këto rrethana eliminimi i ofertes sonë, përveç se Ikundërligjshëm siç u argumentua në pretendimet 1, 2, 3 dhe 4 në të njëjtën kohë do tëkishte pasoja të mëdha për interesin publik të qytetarëve të Komunës së Prishtinës.Kujtojmë se këtë aktivitet të prokurimit AK e ka iniciuar më 28.03.2025, apo para gaticatërmëdhjet muajve dhe ende nuk ka kontratë të nënshkruar, anulimi i këtij aktiviteti tëprokurimit do të nënkuptonte se është pothuajse e pamundur që AK të ketë mundësi qëkëtë vit të nënshkruaj kontratë me ndonjë OE të përzgjedhur. Këto veprime padyshim secenojnë rëndë interesin e Komunës së Prishtinës, posaçërisht nëse merret për bazërendësia e këtij projekti që ka të bëjë me implementimin e furnizimit dhe vendosjes sësistemit mobil në territorin e Komunës së Prishtinës, për mbrojtjen nga përmbytjet,vërshimet, të cilat në vitet e fundit kanë shkaktuar dëme të mëdha materiale në vleramilionëshe.

Në këtë rast si analogji mund të marrim nenin 132, paragrafi 3 të LPP-së ku taksativishttheksohet se: “Gjatë vendosjes për shfuqizimin e një kontrate publike ose konkursi tëprojektimit, pjesërisht ose plotësisht, OSHP ose gjykata duhet të marrin parasysh dëmet nëinteresin publik që mund të rezultojnë nga ky veprim. Nëse OSHP ose Gjykata konstatonse shfuqizimi do të kishte pasoja të rënda në interesin publik, atëherë OSHP ose gjykatanuk do të shfuqizojnë kontratën publike ose konkursin e projektimit, por do të përpiqen tarregullojnë çështjen përmes nxjerrjes së një urdhri për kompensimin e dëmit sipasnëparagrafëve 2.3 dhe/ose 2.4 paragrafi 2. të këtij neni”.Ekziston bazë e fortë juridike për kontestimin e vendimeve të mëparshme të OrganitShqyrtues të Prokurimit, për shkak se të njëjtat janë ndërtuar mbi një vlerësim të mangët,të njëanshëm dhe të pa mbështetur në administrimin e plotë të provave materiale tëdorëzuara në procedurë.Në veçanti, vendimmarrja e OSHP-së dhe vendimi i Autoritetit Kontraktues i cili i kapraprirë kësaj procedure, rezultojnë të jenë mbështetur kryesisht në parashtrësat dhepretendimet e një operatori ekonomik, pa u bërë verifikim i plotë, i pavarur dhe teknik Iautenticitetit të dokumentacionit të kontestuar, pavarësisht se ndaj të njëjtit janë ngriturdyshime të bazuara për falsifikim, manipulim dhe mospërrputhje materiale.Verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar është detyrim ligjor aktiv sipas nenit 59 tëLigjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, si dhe obligim për trajtim të barabartë tëtë gjitha provave relevante, dhe nuk janë ndërmarrë verifikime të thelluar dhe tëpavarur të të gjitha pretendimeve teknike dhe dokumentare, duke u kufizuar në njëvlerësim formal dhe të pjesshëm të parashtrësave.Një qasje e tillë ka rezultuar në marrjen e një vendimi i cili nuk reflekton gjendjen realefaktike të dokumentacionit në dosje, por mbështetet në interpretim të njëanshëm dhe të pabalancuar të provave, duke injoruar elemente thelbësore që lidhen me autenticitetin e

dokumenteve të dorëzuara nga operatori ekonomik. Për më tepër, mosadministrimi i plotë i provave të dorëzuara nga pala jonë, si dhemosadresi substancial i dyshimeve për dokumentacion të falsifikuar, përbën shkelje tëparimit të së vërtetës materiale, parimit të ligjshmërisë dhe detyrimit për arsyetim të plotë dhe të qartë të vendimit administrativ.

Në këtë kontekst, vendimet e OSHP-së, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë mbështetet në këtë gjendje të paqartë faktike dhe në një vlerësim të pjesshëm të provave, rezulton juridikisht i cenueshëm, pasi nuk garanton standardin minimal të shqyrtimit të plotë, objektiv dhe të paanshëm të çështjes.

Rrjedhimisht, ekziston bazë e mjaftueshme ligjore për konstatimin e shkeljes së procedurës administrative dhe prokurimit publik, si dhe për kërkesën për:

- anulimin e vendimeve të kontestuara,
- kthimin e çështjes në rivlerësim të plotë,
- dhe detyrimin për administrim të detyrueshëm të të gjitha provave materiale, përfshirë verifikimin institucional të autenticitetit të dokumentacionit të kontestuar.

Në mungesë të një vlerësimi të tillë të plotë dhe të pavarur, vendimarrja e deritanishme nuk mund të konsiderohet e qëndrueshme juridikisht dhe cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë parimet themelore të prokurimit publik dhe sigurisë juridike të operatorëve ekonomikë.

Ligji për prokurim publik kërkon që vendimet e anulimit të jenë të arsyetuara dhe të dokumentuara, me qëllim që të mos cenohet:

Transparenca;

Barazia e trajtimit të operatorëve ekonomikë;

Konkurenca e ndershme;

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënie e

Kontratave

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 15.05.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0311/2026 ndërsa me datën 19.05.2026 ka autorizuar prap ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0322/2026, ndërsa me datë 28.05.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0311/26 dhe 0322/26 .

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe

dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Eing Com” SH.P.K. & “Mavi Deniz Cevre Hizmetleri” A.S. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0311 kanë vlerësuar si në vijim:

Me datën 13.05.2026, G.O.E. “EING COM” SH.P.K. & “MAVI DENİZ ÇEVRE HİZMETLERİ” A.S. ka paraqitur ankesë në OSHP lidhur me aktivitetin e prokurimit “163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet – Ritender”, me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1, të iniciuar nga AK – Kuvendi i Komunës së Prishtinës. Ankesa është paraqitur kundër vendimit të AK-së për eliminimin e GOE ankues dhe anulimin e aktivitetit të prokurimit. Ankuesi kërkon aprovimin e ankesës, anulimin e vendimit të AK-së të datës 28.04.2026 dhe kthimin e lëndës në rivlerësim.

Pretendimi ankimor:

GOE ankues kundërshton vendimin e AK-së për eliminimin e tij dhe anulimin e aktivitetit të prokurimit, me arsyetimin se AK gjatë rivlerësimit ka konstatuar se dokumenti i paraqitur me titull “Income Tax and VAT Clearance Certificate 2025 – Mavi Deniz (Final)” nuk është autentik, përkatësisht nuk është gjetur në sistemin e verifikimit të Administratës Tatimore të Republikës së Turqisë. Sipas AK-së, mbi këtë bazë oferta e GOE-së është trajtuar si e papërgjegjshme.

GOE ankues pretendon se ky konstatim nuk qëndron, pasi dokumenti i kontestuar nuk ka relevancë me përmbushjen e kërkesave të dosjes së tenderit dhe nuk lidhet me dokumentacionin që dëshmon përgjegjshmërinë teknike/profesionale të ofertës. Sipas ankuesit, vërtetimet që lidhen me përshtatshmërinë sipas nenit 65 të LPP-së kërkojnë vetëm nga tenderuesi të cilin AK synon ta shpërblejë me kontratë, para publikimit të njoftimit B58.

Në kuadër të këtij pretendimi, ankuesi thekson se AK nuk ka respektuar vendimet paraprake të OSHP-së, përkatësisht vendimet nr. 2025/0535 dhe nr. 2025/0560 të datës 19.08.2025, si dhe vendimin nr. 2026/0027 të datës 26.02.2026, dhe se çështja e përgjegjshmërisë së tij tashmë është trajtuar nga OSHP. Ankuesi po ashtu pretendon se AK ka nxjerrë arsye të reja eliminimi pas dy rivlerësimeve, se vlerësimi është ndikuar nga palë të treta/OJQ/media, si dhe se, në rast të paqartësive, AK është dashur të kërkojë sqarime shtesë.

Ankuesi gjithashtu pretendon se vërtetimet e bashkangjitura në ankesë lidhur me nenin 65 të LPP-së pasqyrojnë gjendjen faktike/reale të anëtarit të konsorciumit dhe se këto dokumente, së bashku me sqarimet e ofruara në Organin Shqyrtues, duhet të merren parasysh gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje.

Mbi këtë bazë, ankuesi pretendon shkelje të neneve 1, 6, 7, 59, 69 dhe 72 të LPP-së.

Përgjigje e Ekspertit Shqyrtues ndaj pretendimit ankimor:

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimin ankimor të GOE ankues, raportin e rivlerësimit të Autoritetit Kontraktues, vendimet paraprake të OSHP-së, si dhe dokumentacionin e administruar në procedurë. Në radhë të parë, eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues, gjatë rivlerësimit, nuk ka reflektuar mbi konstatimet dhe udhëzimet e dhëna nga Paneli Shqyrtues në vendimet paraprake të OSHP-së, përkatësisht vendimet OSHP nr. 2025/0535 dhe 2025/0560 të datës 19.08.2025, si

dhe vendimin OSHP nr. 2026/0027 të datës 26.02.2026.

Nga raporti i rivlerësimit rezulton se AK, përveç çështjes së dokumentit “Income Tax and VAT Clearance Certificate 2025 – Mavi Deniz (Final)”, ka përsëritur në substancë arsyet e mëparshme të eliminimit të GOE ankues, të cilat tashmë kanë qenë objekt shqyrtimi nga Paneli Shqyrtues. Këto arsye lidhen me materialet e ofruara PVC/PU, standardet për lidhje dhe ventila, mënyrën e mbushjes së sistemit, gjatësinë e seksioneve, si dhe çështjen e sigurimit të tenderit. Sipas dokumentacionit të administruar, këto çështje nuk paraqiten si rrethana të reja faktike apo juridike, por si çështje të trajtuara më parë në vendimet paraprake të OSHP-së.

Në këto vendime, Paneli Shqyrtues kishte trajtuar arsyet eliminuese të AK-së dhe, sipas materialit të administruar, kishte konstatuar se eliminimi i OE “EING COM” SH.P.K. ishte bërë në kundërshtim me nenet 1, 6, 7, 59 dhe 60 të LPP-së, si dhe se arsyetimi i AK-së në Letrën Standarde për eliminim kishte qenë i pabazuar. Po ashtu, Paneli kishte dhënë orientime lidhur me sistemin AVCP 4, materialet PVC/PU, kërkesat që nuk mund të përdoren si kritere eliminuese nëse nuk janë përcaktuar qartë në Dosjen e Tenderit, si dhe çështjen e sigurimit të tenderit në rastet kur dokumenti ekziston para afatit për dorëzim dhe përmban elementet thelbësore.

Eksperti shqyrtues vlerëson se rivlerësimi është dashur të zhvillohej në harmoni me konstatimet dhe udhëzimet e Panelit Shqyrtues. Në mungesë të elementeve të reja faktike apo juridike, përsëritja e arsyeve të mëparshme eliminuese nuk e përmbush qëllimin e kthimit të lëndës në rivlerësim.

Në këtë fazë, elementi i ri i evidentuar nga AK lidhet me dokumentin për vërtetimin tatimor të anëtarit të konsorciumit “MAVI DENİZ ÇEVRE HİZMETLERİ” A.S. Prandaj, kjo çështje duhet të analizohet në raport me natyrën juridike të dokumentit, fazën procedurale në të cilën kërkohet, nenin 65 të LPP-së, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024 (RrPP), interpretimin përkatës të KRPP-së dhe pikën 6.4 të Dosjes së Tenderit.

Dokumenti i “pretenduar” lidhet me kërkesat e pranueshmërisë sipas nenit 65 të LPP-së, konkretisht me dëshminë se operatori ekonomik nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve në vendin e themelimit. Kjo çështje është e rregulluar me LPP-në, me RrPP-në, si dhe me pikën 6.4 të Dosjes së Tenderit. Si e tillë, ajo nuk mund të përdoret si bazë e drejtpërdrejtë për shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme, pa u respektuar rendi procedural i paraparë për kërkimin, dorëzimin dhe verifikimin e dëshmimeve të pranueshmërisë.

Në këtë drejtim, eksperti shqyrtues sqaron se interpretimi i KRPP-së i datës 22.11.2022 përcakton se në fazën e dorëzimit të ofertës operatorët ekonomikë dëshmojnë pranueshmërinë përmes Deklaratës nën betim. “KRPP ka sqaruar shprehimisht se: “OE-të janë ‘të pranueshëm’ kur ata ofrojnë së bashku me tenderin e tyre dëshminë ‘Deklaratën nën betim’ me të cilën deklarojnë se një gjendje e tillë nuk ekziston.” Ndërsa më tutje sqarohet se: “Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, nga i njëjti kërkohet dëshmia ‘Vërtetimi nga ATK’ dhe për të qenë ‘i pranueshëm’ OE sipas nenit 65 të LPP-së, duhet të vërtetohet se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së.” Ky interpretim është në harmoni edhe me nenin 25.9 të RrPP-së, i cili përcakton se vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë kërkohen të dorëzohen nga tenderuesi të cilin Autoriteti Kontraktues ka për qëllim ta shpërblejë me kontratë. Sipas kësaj dispozite, këto dokumente duhet të dorëzohen para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së, ndërsa afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit nuk mund të jetë më pak se pesë ditë nga marrja e njoftimit të AK-së për synimin e dhënies së kontratës.

Po ashtu, pika 6.4 e Dosjes së Tenderit përcakton se, përveç deklaratës së shkruar nën betim të nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2, dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë kërkohej nga tenderuesi të cilit Autoriteti Kontraktues ka ndër mend t'ia japë kontratën.

Sa i përket “pretendimit për dokument të falsifikuar”, eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues mund të evidentojë mospërputhje, dyshime apo indicie lidhur me autenticitetin e një dokumenti të dorëzuar në procedurë. Megjithatë, cilësimi përfundimtar si dokument i falsifikuar kërkon verifikim nga organet kompetente. Në aspektin e prokurimit publik, ndikimi i një dokumenti të tillë duhet të vlerësohet sipas relevancës së tij, fazës procedurale në të cilën kërkohej dhe ndikimit në pranueshmërinë e operatorit ekonomik në procedurë.

Në rastin konkret, dokumenti i pretenduar lidhet me dëshmitë e pranueshmërisë sipas nenit 65 të LPP-së, të cilat, sipas pikës 6.4 të Dosjes së Tenderit, kërkohej nga tenderuesi të cilin AK ka për qëllim ta shpërblejë me kontratë, para publikimit të Njoftimit B58. Për këtë arsye, dokumenti i tillë nuk është dashur të trajtohet nga Komisioni i Vlerësimit si kriter i drejtpërdrejtë eliminues në fazën e rivlerësimit, pa u respektuar paraprakisht procedura e kërimit dhe dorëzimit të dëshmive të pranueshmërisë.

Prandaj, pas fazës së rekomandimit për kontratë sipas vendimeve të OSHP-së, dhe pas dorëzimit të dëshmive të pranueshmërisë nga operatori ekonomik i rekomanduar, AK mund të ndërmarrë veprime të kontrollit efektiv të dokumenteve, në kuptim të nenit 52.7 të LPP-së. Nëse gjatë këtij kontrolli paraqiten mospërputhje apo dyshime lidhur me autenticitetin e dokumentit, çështja mund të trajtohet sipas kompetencave të AK-së dhe, dhe sipas nevojës, të adresohet tek organet kompetente.

Në përfundim, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i GOE ankues është i bazuar në aspekt procedural dhe provues, pasi AK fillimisht është dashur të respektojë rendin procedural për kërkimin dhe dorëzimin e dëshmive të pranueshmërisë nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, e më pas, në rast dyshimi për dokumentet të cilat i ofron OE i rekomanduar, AK të ndërmarrë veprime të kontrollit efektiv të tyre në kuptim të nenit 52.7 të LPP-së.

Lidhur me pretendimet e OE “Diga Solution” L.L.C. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0322 kanë vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe vendimet paraprake të Panelit Shqyrtues, vlerëson se në rastin konkret duhet marrë parasysh fakti se përgjegjshmëria administrative e ofertës së OE ankues tashmë ka qenë objekt shqyrtimi dhe vendimmarrjeje nga Paneli Shqyrtues.

Nga shkresat e lëndës rezulton se GOE “DIGA Solutions L.L.C.”, së bashku me partnerët ED-Construction Sh.P.K. dhe IMK Sh.P.K., fillimisht ka qenë i rekomanduar për kontratë nga Autoriteti Kontraktues. Megjithatë, me vendimet OSHP: 2025/0535 dhe OSHP: 2025/0560, të datës 19.08.2025, Paneli Shqyrtues ka trajtuar përgjegjshmërinë e ofertës së këtij GOE, përfshirë çështjen e Marrëveshjes për themelimin e grupit sipas formatit standard të KRPP-së, siç kërkohej me nenin 26.15 të Rregullores për Prokurimin Publik Nr. 002/2024, dhe ka konstatuar se mungesa e formularit standard të miratuar për themelimin e grupit përbën kusht administrativ eliminues.

Eksperti shqyrtues vëren se, pas këtij vendimi dhe pavarësisht konstatimeve të Panelit Shqyrtues, nga shkresat e lëndës rezulton se gjatë rivlerësimit GOE “DIGA Solutions L.L.C.” është rekomanduar sërish për kontratë nga Autoriteti Kontraktues. Kjo çështje është trajtuar përsëri

nga Paneli Shqyrtues me vendimin OSHP: 2026/0027, të datës 26.02.2026, ku Paneli ka theksuar se tashmë kishte vendosur lidhur me këtë çështje. Në të njëjtin vendim, Paneli ka konstatuar se: “Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit t’u përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.”

Në përputhje me nenin 105 paragrafi 2.16 të LPP-së, si dhe me praktikën e Panelit Shqyrtues në vendimet OSHP: 2024/0675, OSHP: 2024/0504-0506 dhe vendime të tjera të ngjashme, në rastet kur çështja është shqyrtuar më parë dhe operatori ekonomik është konsideruar i papërgjegjshëm, pretendimet e përsëritura nuk trajtohen, por konsiderohen çështje e gjykuar “res judicata”. Në këto raste, operatori ekonomik nuk arrin të dëshmojë statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-së. Përfundimisht, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore të OE “DIGA Solutions L.L.C.” nuk mund të trajtohen si pretendime që prodhojnë interes të drejtpërdrejtë juridik material për ankuesin, pasi me vendimet OSHP: 2025/0535 dhe OSHP: 2025/0560 të datës 19.08.2025, si dhe me vendimin OSHP: 2026/0027 të datës 26.02.2026, është trajtuar dhe rikonfirmuar papërgjegjshmëria administrative e ofertës së tij.

-Seanca shqyrtuese-

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrësat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë. Ankesa e GOE “Eing Com” SH.P.K. & “Mavi Deniz Cevre Hizmetleri” A.S. e parashtruar në Organin

Shqyrtues të Prokurimit me 13.05.2026 me numër protokoli 0311/26, Paneli Shqyrtues vlerëson se kjo lende është trajtuar me vendimet e Panelit Shqyrtues ku janë nxjerrur vendimet paraprake të OSHP-së nr **2025/0535**, **2025/0560** të datës 19.08.2025, si dhe vendimin nr. **2026/0027** të datës 26.02.2026. andaj e konsideron si qështje te gjykuar ankesen (Res Judicate) , sikurse parashihet në nenin 16.3 te Rregullores se punes , ne kuptim te nenit 105.2.16 te LPP-se.

Ndërsa lidhur me ankesën e Operatorit Ekonomik “Diga Solution” L.L.C. e parashtruar ne Organin Shqyrtues te Prokurimit me 14.05.2026 me numër protokoli 0322/26, nuk dëshmon interes juridik material për shqyrtim ne lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: “163 Ndertimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi I lumenjeve dhe kanalizimeve per mbrojtje nga vershimet - RiTender” me nr. të prokurimit: 616-25-2547-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtines.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Kompetente në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - EING COM SH.P.K., DIGA Solutions L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: